

Bedri Hamza, sërish
kandidat i PDK-së për
kryeministër

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

UDHËKRYQET E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

FAQE 4



Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, gjasat për të cilat u rritën dukshëm më 26 tetor pasi Kuvendi nuk e aprovoi një qeveri të re të Albin Kurtit, do të mund të sillnin ndryshime në rezultatet e partive, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike

AKTUALE



SHBA-ja DHE JAPONIA LAVDËROJNË
"EPOKËN E ARTË" TË ALEANCËS,
ARRIJNË MARRËVESHJE PËR
MINERALET E RRALLA F. 3

KURTI PARALAJMËRON ZGJEDHJE
PARLAMENTARE EDHE NË
DHJETOR, EDHE NË PRANVERË F. 5

SINDIKATA E PUNËTORËVE
TË RTK-së KËRKON NGA KUVENDI
ALOKIMIN E BUXHETIT F. 7

EKONOMI



HAKI SHATRI: NËSE NGA 1 JANARI
S'KA QEVERI TË RE, NUK DO TË
KETË KUSH TA PROPOZOJË
VAZHDIMIN E SHPENZIMEVE
BUXHETORE F. 8

SPORT



FITOJNË BALLKANI DHE
DUKAGJINI F. 11



EDI RAMA: EMRI I HASHIMIT DO TË MBETET
PËRGJITHNJË SI EMRI I NJERIUT QË U BË NJËSH
ME FATIN, LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS F. 3

ZYRTARIZOHET EMËRIMI
I LIBURN ALIUT DREJTOR
I PORTIT TË DURRËSIT F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE

INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com



Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY
Digital Agency

Endrit Shaqiri
+38344685122

Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja DHE JAPONIA LAVDËROJNË “EPOKËN E ARTË” TË ALEANCËS, ARRIJNË MARRËVESHJE PËR MINERALET E RRALLA

TOKIO, 28 TETOR - Kryeministrja e re e Japonisë, Sanae Takaichi, dhe presidenti amerikan Donald Trump, lavdëruan “epokën e artë” të raporteve mes vendeve gjatë vizitës së udhëheqësit amerikan në Tokio. Dy shtetet nënshkruan një marrëveshje që synon t'i sigurojë Uashingtonit minerale të rralla. Takaichi, gruaja e parë kryeministre në Japoni, lavdëroi Trumpin dhe njoftoi se do ta nominojë atë për Çmimin Nobel për Paqe, tha Shtëpia e Bardhë. Në këmbim, Trump, i cili u takua për herë të parë me Takaichin gjatë turneut të tij në Azi, tha se Uashingtoni është aleat “i nivelit më të fortë të mundshëm”. “Është një nder i madh të jem me ju, veçanërisht kaq herët në atë që mendoj se do të jetë një nga kryeministret më të mira”, i tha Trump Takaichit në pallatin shtetëror Akasaka. Takaichi e lavdëroi Trumpin për përpjekjet e tij drejt një armëpushimi mes Tajlandës

dhe Kamboxhias dhe për “arritjen e tij historike dhe të paprecedent” të marrëveshjes për Gazën. “Do të doja të realizoja një epokë të re të artë të aleancës Japoni - ShBA, ku si Japonia ashtu edhe Shtetet e Bashkuara do të bëhen më të forta dhe më të begata”, tha ajo. Të dyja palët gjithashtu nënshkruan një marrëveshje që synon “forcimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së zinxhirëve të furnizimit me minerale kritike dhe elemente të rralla tokësore”, u tha në deklaratë. Pekini këtë muaj njoftoi kufizime të gjera në industrinë e elementeve të rralla, gjë që e shtyu Trumpin që të paralajmëronte se si kundërpërgjigje do t'i vendosë tarifë prej 100 për qind importeve nga Kina. Pas takimit me kryeministren Takaichi, presidenti Trump u takua me familjarët e japonezëve të rrëmbyer nga Koreja e Veriut dekada më parë, ku tha se “ShBA qëndron



plotësisht me ta”, teksa ata kërkuar ndihmë për gjetjen e më të dashurve të tyre. Pasi për vite të tëra e mohoi, Koreja e Veriut e pranoi më 2002 se kishte dërguar agjentë për të rrëmbyer 13 shtetas japonezë, të cilët u përdorën për të trajnuar spiunë për gjuhën dhe zakonet japoneze. Japonia thotë se janë rrëmbyer edhe

persona të tjerë. Trumpi arriti në Japoni të hënën dhe gjatë turneut në Azi pritët të takohet edhe me homologun kinez Xi Jinping, takim që mund të ndihmojë në tejkalimin e luftës tregtare mes dy vendeve. Negociatorët nga Uashingtoni dhe Pekini kanë konfirmuar se është arritur një “marrëveshje

kornizë” mes dy ekonomive më të mëdha të botës. Sa i përket sigurisë, Japonia gjithnjë e më shumë po merr një qëndrim më të fortë ushtarak teksa raportet me Kinën janë përkeqësuar. Takaichi, që javën e kaluar u bë gruaja e parë kryeministre në Japoni, ka thënë se qeveria e saj do ta arrijë synimin që të shpenzojë dy për qind të GDP-së në mbrojtje - dy vjet më herët sesa parashikimet paraprake. ShBA-ja, që ka rreth 60 mijë pjesëtarë të personelit ushtarak në Japoni, dëshiron që Tokio të shpenzojë edhe më shumë në mbrojtje, potencialisht të arrijë në 5 për qind, ashtu siç ishin zotuar anëtarët e NATO-s në qershor. Përveç takimit me Takaichin, Trumpi do të mbajë edhe një fjalim në aeroplanmbajtësen amerikane USS George Washington, që është ankoruar në bazën detare amerikane Yokosuka. Gjatë qëndrimit në Japoni, ai do të takohet edhe me udhëheqës të biznesit.

ZELENSKY THOTË SE KA NEVOJË PËR MBËSHTETJEN EVROPIANE DHE PËR “DY-TRE VJET LUFTIME”

KIEV, 28 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha se shteti i tij ka nevojë për ndihmë financiare të Evropës për ta vazhduar luftën kundër forcave ruse për dy apo tre vjet të tjera. Kievi është varur kryesisht nga mbështetja ushtarake dhe financiare e aleatëve për të mbajtur nën kontroll ushtrinë e Moskës, e cila nisi pushtimin e plotë të shtetit fqinj në shkurt të vitit 2022. “Unë e theksova këtë përsëri për të gjithë udhëheqësit evropianë. U thashë atyre se ne nuk do të luftojmë për dekada, por ju duhet të tregoni që për një kohë do të mund të siguron mbështetje të qëndrueshme financiare për Ukrainën”, tha Zelensky në komente të



publikuara të martën. “Dhe pikërisht për këtë ata kanë këtë program në mendje - 2-3 vjet”, tha Zelensky, duke iu referuar planeve të Brukselit për

t'i përdorur asetet e ngrira ruse për ta ndihmuar Kievin. Javën e kaluar udhëheqësit e Bashkimit Evropian e ngarkuan Komisionin Evropian të

vazhdojë me opsionet për financimin e Ukrainës për dy vjet të tjerë, duke lënë hapur mundësinë për një kredi të madhe që do të përdorte disa dhjetëra miliarda euro nga asetet shtetërore ruse që Brukseli i ka ngrirë. “Nëse lufta përfundon brenda një muaji, do t'i shpenzojmë këto para për rikuperim. Nëse nuk përfundon brenda një muaji, por pas një kohe, atëherë do t'i shpenzojmë për armë. Thjesht, nuk kemi zgjedhje tjetër”, shtoi Zelensky. Udhëheqësi ukrainas, po ashtu, bëri thirrje që presidenti amerikan Donald Trump që t'i ushtrojë presion homologut kinez Xi Jinping, që ta ndërpresë mbështetjen për Rusinë kur të

takohet me të më vonë këtë javë. “Mendoj se kjo mund të jetë një nga lëvizjet e forta të [Trumpit], veçmas nëse, pas këtij hapi vendimtar të sanksioneve, Kina është gati t'i reduktojë importet” nga Rusia, tha Zelensky për gazetarët, përfshirë AFP, në një konferencë për gazetarë, komentet nga e cila u publikuan më 28 tetor. Javën e kaluar, Trumpi vendosi sanksione ndaj dy kompanive kryesore të naftës ruse dhe udhëheqësi amerikan ka bërë thirrje që blerësit e energjisë ruse - konkretisht Kina dhe India - t'i ndalin blerjet, pasi të ardhurat nga energjia, sipas Uashingtonit dhe Kievit, po e financojnë luftën kundër Ukrainës.

Turqia nënshkruan marrëveshje me Britaninë për blerjen e 20 avionëve luftarakë

LONDËR, 28 TETOR - Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, Keir Starmer, e ka nënshkruar një marrëveshje përmes së cilës Turqia i bleu 20 avionë luftarakë, Eurofighter Typhoon, për 8 miliardë funte, tha zyra e tij. Në korrik, Turqia dhe Britania

kishin nënshkruar marrëveshje paraprake për blerjen e 40 avionëve Typhoon, të miratuar nga anëtarët e konsorciumit Eurofighter, përfshirë Gjermaninë, Italinë dhe Spanjën dhe të përfaqësuar nga kompanitë Airbus, BAE Systems dhe Leonardo.

Starmer u takua me presidentin turk Tayyip Recep Erdogan në Ankara të hënën për ta nënshkruar marrëveshjen. Turqia po kërkon të përfitojë nga këta avionë luftarakë të avancuar për të mos mbetur mbrapa rivalëve rajonalë si Izraeli, i cili këtë vit ka kryer

sulme në të gjithë Lindjen e Mesme. Turqia, e cila tani po gëzon marrëdhëniet më të ngrohta me Perëndimin në vitet e fundit, ka kërkuar të blejë Eurofighter dhe potencialisht edhe avionë amerikanë F-35 për ta mbështetur flotën e saj të



vjetër, e cila përbëhet kryesisht nga avionë F-16.

EDI RAMA: EMRI I HASHIMIT DO TË MBETET PËRGJITHNJË SI EMRI I NJERIUT QË U BË NJËSH ME FATIN, LIRINË DHE PAVARËSINË E KOSOVËS

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

Tiranë, 28 tetor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka publikuar një foto të ish-presidentit Hashim Thaçi dhe ish-kryegjeneralit të NATO-s, Wesley Clark, derisa ka kritikuar ashpër procesin gjyqësor kundër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. “A nuk është e tmerrshme ta mendosh se shpëtimtarët e një kohe kur vetë ekzistenca e Kosovës ishte në tehun e thikës së gjatë të padrejtësisë historike ndaj shqiptarëve, duhet të paraqiten para një gjykate të dalë krejt nga shinat

mbi të cilat u ngrit, për të dëshmuar se lufta për liri nuk është krim, se rebelimi ndaj një diktature nacional-socialiste nuk është faj, se shteti i ri e sovran i Kosovës nuk ka dalë nga barku i një ndërmarrjeje kriminale, po nga gjaku i një ushtrie çlirimtare?!” ka shkruar Rama nw “Facebook”.

Ai ka kritikuar ashpër ata që i quajti “shqipsharës digjitalë” dhe “tifoze të verbuar” të cilët e trajtojnë Thaçin si “armik politik” dhe shpresojnë që të mos dalë kurrë nga burgu, duke e vlerësuar pozicionin e tyre shkurtëpamës në aspektin historik. “Çfarë turpi për drejtësinë

ndërkombëtare dhe edhe më zi për shqipsharësit digjitalë, tifoze të verbuar prej budallakisë kinse patriotike, që edhe mbrapa hekurave të kësaj padrejtësie ulëritëse, e shohin dhe trajtojnë Hashim Thaçin si armik politik, duke uruar të mos dalë më kurrë prej aty; ndërkohë që kur atyre t’u jetë harruar nami e nishani dhe asaj gjykate t’i ketë mbetur vetëm njolla e turpit të historisë, emri i Hashimit do të mbetet përgjithnjë si emri i njeriut që u bë njësh me fatin, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës”, ka shkruar Rama. Ndryshe, gjenerali amerikan në pension, njeriu që ka



udhëhequr fushatën ajrore të NATO-s kundër Serbisë në vitin 1999, do të dëshmojë në mbrojtje të ish-presidentit të Kosovës, i cili është subjekt i

akuzave për krime të pretenduara lufte dhe krime kundër njerëzimit në Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë të Holandës.

NË PRITJE TË KOMISIONIT EVROPIAN: ÇFARË DO TË PËRFSHIJË RAPORTI PËR KOSOVËN?

PRISHTINË, 28 TETOR - Komisioni Evropian pritet ta miratojë dhe ta publikojë së shpejti paketën vjetore të zgjerimit, së bashku me raportet e përparimit për vendet që përfshihen në këtë proces, në përputhje me orarin tradicional të Paketës Vjetore të Bashkimit Evropian.

Në bazë të agjendës së publikuar nga Kolegji i KE-së, paketa vjetore e zgjerimit është planifikuar të publikohet më 29 tetor. Kjo do të jetë paketa e



parë e zgjerimit që do të miratohet nga përbërja e re e KE-së, pas marrjes së mandatit në janar të vitin 2025.

Sa i përket Kosovës, raporti

pritet të vlerësojë nëse është bërë përparim në sektorët kyç të qeverisjes dhe reformave, përfshirë sundimin e ligjit, administratën publike, luftën kundër korrupsionit, avancimin e shërbimeve publike dhe tranzicionin e gjelbër, raporton “albanianpost”.

Raporti i Progresit për Kosovën pritet të përmbajë vërejtje për mungesën e gatishmërisë për t’i zbatuar obligimet që dalin

nga dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. KE-ja pritet që të bëjë ftesë për më shumë përparim në sigurimin e një gjyqësori të pavarur dhe për respektimin e lirisë së medias.

Gjithashtu, situata politike dhe ajo e sigurisë në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe do të jenë në fokus, krahas ngërçit politik në vend pas zgjedhjeve të fundit parlamentare, cili ka

ndikuar drejtpërdrejt në zbatimin e reformave dhe bllokimin e Planit të Rritjes të BE-së, nga i cili Kosova mund të përfitojë mbi 880 milionë euro. Një pjesë e raportit pritet t’u kushtohet edhe masave ndëshkuese. BE-ja ka sinjalizuar se mbarëvajtja e zgjedhjeve lokale, veçanërisht pjesëmarrja e komunitetit serb, mund të ndikojë në mënyrë pozitive në procesin e heqjes graduale së këtyre masave.

KRYEZIU, ISH-OPOZITËS: NËSE S’KENI GUXIM TË QEVERISNI, PSE TË SHKOJMË NË ZGJEDHJE?

PRISHTINË, 28 TETOR - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës, Ismet Kryeziu, ka deklaruar se pas dështimit për zgjedhjen e qeverisë Kurti 3, Kosova ka hyrë në një momentum të ri politik. Kryeziu ka pyetur se “pse askush nuk po do, nuk po guxon apo nuk po arrin të qeverisë me vendin?”. “Nëse PDK-ja dhe LDK-ja nuk e kanë guximin dhe vullnetin për ta marrë përgjegjësinë që u jep mundësia e numrave

parlamentarë për të krijuar një qeverisje alternative pas refuzimit të Kurtit 3, atëherë pse duhet të shkojmë në zgjedhje?”, ka thënë ai përmes një shkrimi në rrjetin social ‘Facebook’.

Ndër të tjera, Kryeziu ka potencuar edhe rëndësinë e zgjedhjeve. “Zgjedhjet nuk janë lojë fëmijësh të tipit “edhe një herë” derisa të barazohemi ose të fitojmë. Ato janë mekanizëm demokratik për zgjidhje, jo për



përsëritje pafund të një ngërçi politik”. Presidentja Vjosa Osmani pritet t’i thërrasë brenda 10 ditësh

liderët e partive politike për të emëruar një mandatar të dytë për kryeministër ose për të marrë vendim që Kosova të shkojë në zgjedhje të parakohshme.

Mandatarin i ri pritet të jetë ai që ka gjasat më të mëdha për të formuar qeverinë, pas dështimit të kryetarit të Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili doli i pari në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit për ta krijuar ekzekutivin. Megjithatë,

ish-opozita ende nuk ka shprehur gatishmëri për të marrë iniciativë për formimin e qeverisë së re.

Kreu i partisë së dytë të dalë nga zgjedhjet e 9 shkurtit, Memli Krasniqi nga Partia Demokratike e Kosovës, ka thënë se do t’i kërkojë presidentes Vjosa Osmani që të shkohet në zgjedhje menjëherë, pasi nuk i kanë numrat e mjaftueshëm për ta formuar ekzekutivin.

Kufizohen shpenzimet për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale

PRISHTINË, 28 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kufizuar shpenzimet e fushatës zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave që do të mbahet më 9 nëntor.

Në listën e votuesve brenda vendit për raundin e dytë janë të regjistruar 1 316 672 votues. Kufiri i sipërm i shpenzimeve të fushatës është 2 633 344 euro, respektivisht dy euro për çdo votues të regjistruar. Fushata

do të zhvillohet nga 3 deri më 9 nëntor (ora 06:59). Subjektet politike nuk mund ta tejkalojnë këtë vlerë në komunat ku garojnë.

KQZ-ja kishte njoftuar se për komunat që do të shkojnë në balotazh më 9 nëntor nuk do të hapet asnjë periudhë e re për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës.

Raundi i balotazhit do të zhvillohet më 9 nëntor në 18 komuna dhe KQZ-ja veçse ka

certifikuar listën e votuesve për votimet. Balotazh do të ketë në Gjakovë, Gjilan, Dragash, Kaçanik, Klinë, Fushë-Kosovë, Mitrovicë e Jugut, Obiliq, Rahovec, Pejë, Prishtinë, Prizren, Suharekë, Viti, Vushtrri, Junik, Mamushë dhe Kllokot. Për këtë raund zgjedhesh do të shtypen 1 milion e 158 e 15 fletëvotime, rreth 16 për qind më pak se numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote në këtë raund.





UDHËKRYQET E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, gjasat për të cilat u rritën dukshëm më 26 tetor pasi Kuvendi nuk e aprovoi një qeveri të re të Albin Kurtit, do të mund të sillnin ndryshime në rezultatet e partive, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike

PRISHTINË, 28 TETOR - Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, gjasat për të cilat u rritën dukshëm më 26 tetor pasi Kuvendi nuk e aprovoi një qeveri të re të Albin Kurtit, do të mund të sillnin ndryshime në rezultatet e partive, vlerësojnë njohësit e zhvillimeve politike. Por, sipas tyre, ato ndryshime nuk do të ishin të mjaftueshme, aq sa partitë ta shmangnin nevojën për bashkëqeverisje në të ardhmen. Sipas Kushtetutës së Kosovës, presidentja Vjosa Osmani duhet ta caktojë një mandatar tjetër për formimin e qeverisë brenda 10 ditësh. Por, lideri i partisë së dytë më të votuar, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, hodhi poshtë mundësinë që të bëhet

mandatar i radhës, në rast se presidentja e Kosovës do ta thërrasë për ta pyetur nëse e ka shumicën. Edhe Kurti, udhëheqës i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), e cila fitoi më së shumti vende në Kuvend nga zgjedhjet e 9 shkurtit, pranoi se zgjedhjet e reja mund të kenë mbetur opsioni i vetëm përpara për kalimin e krizës.

Zgjedhjet nuk sigurojnë qeverisje pa koalicione

Politologu Dritëro Arifi vlerëson se janë disa faktorë që do të ndikojnë në rezultatet e zgjedhjeve të ardhshme të parakohshme. Arifi thotë për “Radion Evropa e Lirë” se rezultatet në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të disa prej komunave më të mëdha të Kosovës do t’u japin drejtim partive që do t’i fitojnë ato për t’u pozicionuar edhe për zgjedhjet parlamentare. Sipas tij, qasja e partive politike në fushatë zgjedhore dhe retorika e matur do të jenë ndër përcaktuesit e rezultateve, si dhe të koalicioneve eventuale para dhe pas zgjedhjeve. “Jam i bindur, nga ajo që po ndodh në terren, që asnjëra parti nuk do ta ketë shumicën fillestare për ta bërë qeverinë me 61 [vota]. Edhe nëse e merr ndonjëra parti, do ta ketë vështirë që ta realizojë agjendën. Pra, gjithsesi duhet një bashkëpunim i madh”, shpreh Arifi. Ai thotë se e sheh si të

mundshme që partitë më të vogla, sikurse Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Socialdemokrate, të futen në koalicione parazgjedhore me partitë e mëdha, kryesisht me ato ish-opozitare, sikurse PDK-ja ose Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Ngjashëm, ndryshime pret edhe Rrahman Paçarizi, profesor në Departamentin e Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës. Paçarizi thotë për “Radion Evropa e Lirë” se në rast se partitë më të vogla, si Nisma apo AAK-ja, nuk futen në koalicione parazgjedhore, ato rrezikojnë të mos arrijnë rezultatet që do t’u sigurojnë vend në Kuvend. Në një situatë të tillë, vlerëson ai, votat e këtyre partive mund të shpërndahen proporcionalisht të partitë e tjera më të mëdha. “Unë besoj se do të ketë ndryshim numrash... Mirëpo, megjithatë, unë vështirë se shoh ndonjë ndryshim esencial, i cili do ta siguronte zgjedhjen e një qeverie pa vështirësi të theksuara. Fakti që Lista Serbe nuk hyn në kombinimet e asnjërit bllok politik për ta bërë qeverinë, do të thotë se janë 10 vota mangët për këdo që synon ta bëjë qeverinë”, thekson Paçarizi. “Radio Evropa e Lirë” bëri përpjekje të kontaktonte zyrtarë të AAK-së dhe të Nismës, por ata ishin të paqasshëm. Por, kreu i Nismës, Fatmir Limaj, zhvilloi një takim me kryetarin e LDK-së, Lumir Abdixhiku, të hënë. Ata nuk

deshën të tregonin për medie se për çfarë biseduan.

Frikë nga qeverisja?

Pavarësisht prej pritjeve se zgjedhjet e parakohshme parlamentare mund të prodhojnë ndryshim në numrat e partive politike në Kuvend, vendi vlerësohet se sërish rrezikon të futet në krizë institucionale në rast se ato nuk shfaqin vullnet politik për bashkëpunim. Bashkëpunimi i tillë do të ishte më se i domosdoshëm, thotë Arifi, për shkak se zgjedhjet e parakohshme parlamentare do t’i përcaktonin edhe pretenduesit për tri pozitat më të larta shtetërore. Në këtë drejtim, sipas Arifit, është i domosdoshëm kompromisi ndërmjet partive politike, i cili do të jetë i pamundur pa një gjuhë korrekte të partive politike shqiptare gjatë fushatës zgjedhore. “Synimi do të jetë krijimi i koalicionit të madh shqiptar, pavarësisht se cilat parti do të jenë, sepse ajo i zgjidh të tri nyjat kryesore: kryeministrin, kryeparlamentarin dhe presidentin. Prandaj, të gjitha partitë, pavarësisht se cila - Vetëvendosje, PDK ose LDK - do të jenë të detyruara të bashkëpunojnë, varësisht nga koalicionet”, thotë Arifi. Një koalicion të mundshëm ndërmjet dy ose më shumë partive të mëdha e sheh si zgjidhje edhe Paçarizi. Por, ai

është skeptik se koalicioni i tillë mund të ndodhë edhe pas zgjedhjeve të parakohshme të mundshme. Paçarizi pret që të dyja blloqet aktuale politike, LV-ja në njërën anë, dhe PDK-ja e LDK-ja në anën tjetër, të fitojnë rreth 40 për qind të votave nga zgjedhjet. Të dy taborëve, sipas tij, u mungon vullneti politik për formimin e qeverisë, edhe nëse kjo do të ishte e mundur. “Asnjëra nga forcat politike, si e vetme, nuk ka guxim që të marrë përsipër drejtimin e vendit, pasi kanë frikë se çfarë do të sjellë e nesërmja, në kuptim të dialogut me Serbinë. A do të mund të vihen para një situatë ‘merre ose lëre’, e cila do të ishte pastaj një përgjegjësi shumë e madhe dhe do ta fundoste një qeveri me bazë jo shumë të gjerë”, thotë Paçarizi. Si rrjedhojë, shton ai, vendi rrezikon të futet në një agoni institucionale edhe pas zgjedhjeve të parakohshme eventuale, në rast se nuk do të ketë një ndërhyrje nga ana e vendeve partnere dhe aleate të Kosovës. “Kjo ndërhyrje nuk nënkupton ndihmën për ta bërë qeverinë. Por, nënkupton dhënien, përkatësisht marrjen e garancive, për rrugën tutje, për atë se çka e pret dhe si duhet të silllet dhe të veprojë qeveria e re”, vlerëson Paçarizi. Ai shton se në këtë drejtim e domosdoshme do të jetë një qeveri me bazë të gjerë dhe një president konsensual, i cili jo domosdo duhet të ketë përkatësi partiake.

KURTI PARALAJMËRON ZGJEDHJE PARLAMENTARE EDHE NË DHJETOR, EDHE NË PRANVERË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 TETOR -

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka paralajmëruar se vendi mund të përballlet me zgjedhje parlamentare dy herë brenda muajsh, një ditë pasi dështoi ta fitojë mbështetjen e nevojshme në Kuvend për mandatin e tretë. Duke folur në një konferencë për medie të hënën, Kurti tha se çështja e zgjedhjes së presidentit të ri të vendit në pranverë mund ta çojë vendin përsëri në zgjedhje. “Mbase është për të ardhur keq që do të mund të kemi, përveç balotazhit [të zgjedhjeve lokale në nëntor] dhe dy herë zgjedhje. Edhe zgjedhje në dimër, edhe zgjedhje në pranverë”, tha Kurti në Prishtinë.

Ai ka theksuar se i kanë bërë ftesë dy herë LDK-së dhe kanë qenë në kontakt të vazhdueshëm me Nismën. “LDK-ja refuzon kategorikisht një qeveri të

udhëhequr nga unë, kurse Nisma përfundimisht nuk dëshironte të jetë në një qeveri që e drejtoj unë. Po të rezononin ndryshe këto dy parti dhe ta pranonin ofertën tonë për bashkëpunim, ne jo vetëm që do t'i kishim numrat e nevojshëm për ta formuar qeverinë e re nga kjo legjislaturë e zgjedhjeve parlamentare të rregullta, të lira e të ndershme të 9 shkurtit sivjet, por edhe do të mund t'i jepnim zgjidhje çështjes së zgjedhjes së presidentit, e cila na pret pas vetëm katër muajve”, ka thënë Kurti, duke shtuar se do të angazhohen të punojnë që ta zhvillojnë shtetin e jo që ta mbajnë pushtetin. “Prandaj, para çdo marrëveshje që shtrembëron vullnetin e qytetarëve në zgjedhje, ne zgjedhim zgjedhjet”, është shprehur Kurti.

Presidentes Vjosa Osmani i mbaron mandati në prill të vitit 2026. “Sepse kur nuk arritëm t'i bëjmë 61 deputetë për një qeveri

të re, atëherë është vështirë e imagjinueshme që do t'i bëjmë kollaj 80 deputetë në pranverën e vitit të ardhshëm dhe i kemi edhe katër muaj deri në zgjedhjen e presidentit”, theksoi ai.

Presidenti zgjidhet me dy të tretat e votave të 120 deputetëve sa i ka gjithsej Kuvendi. Në rast se kandidati nuk i merr këto vota në dy raundet e para, në raundin e tretë zgjidhet me votat e gjysmës së deputetëve.

Në rast se nuk zgjidhet as në raundin e tretë, atëherë Kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja.

Vetëm 56 deputetë votuan për kabinetin e propozuar nga Kurti në seancën e së dielës, pra pesë më pak se 61 votat e nevojshme. Pesëdhjetë e dy votuan kundër, ndërsa katër abstenuan.

Tani, sipas Kushtetutës së Kosovës, i takon presidentes Osmani ta caktojë një mandatar tjetër për formimin e qeverisë brenda 10 ditësh.

Por, lideri i partisë së dytë më të

votuar, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, hodhi poshtë mundësinë që të bëhet mandatar i radhës, në rast se presidentja e Kosovës do ta thërrasë për ta pyetur nëse e ka shumicën.

Kurti theksoi se, pas votimit të së dielës, “nuk ka rrugë apo mënyrë tjetër, përveç se drejt zgjedhjeve të reja. Nuk ka qenë preferenca jonë”.

Nëse as pas përpjekjes së dytë qeveria nuk mund të formohet, presidentja duhet të shpallë zgjedhje të reja të cilat duhet të mbahen brenda 40 ditësh.

Njohësit e zhvillimeve politike thonë se zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mund të sillnin ndryshime në rezultatet e partive, por ato ndryshime nuk do të ishin të mjaftueshme, aq sa partitë ta shmangnin nevojën për bashkëqeverisje në të ardhmen. Kosova është zhytur në një paralizë politike qysh prej shkurtit, kur zgjedhjet

parlamentare nuk prodhuan fitues të qartë, një herë me dështimet e vazhdueshme për ta konstituuar Kuvendin dhe pastaj qeverinë e re.

Kriza mund t'i kushtojë vendit me humbjen e fondeve nga Plani i Rritjes 2024-2027 i Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor.

Plani i Rritjes përmban një paketë prej gjashtë miliardë eurosh për ta përkrahur përafrimin e ekonomive të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor me standardet evropiane. Nga kjo paketë, Kosova mund të përfitojë mbi 880 milionë euro, prej të cilave mbi 250 milionë grant pa kthim, ndërsa pjesa tjetër në formë kredie me kushte të favorshme.

Kosova ishte ndër të parat që miratoi agjendën e reformave, por fondet mbeten të bllokuara për shkak të mungesës së institucioneve që ta ratifikojnë marrëveshjen formale me BE-në.



Bedri Hamza, sërish kandidat i PDK-së për kryeministër

PRISHTINË, 28 TETOR - Në rast se vendi shkon në zgjedhje të jashtëzakonshme, Partia Demokratike e Kosovës do të garojë sërish me Bedri Hamzën kandidat për kryeministër. Këtë e ka konfirmuar kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. “Unë besoj që po. Siç e kam thënë prej ditës kur e kam nominuar, dhe tash bëhet më shumë se një vit nga ajo kohë, ai (Bedri Hamza) është personi më i duhur për fazën që po na pret”, ka deklaruar

Krasniqi në “Klan Kosova”. Sipas tij, gjendja në Kosovë është përkeqësuar si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në mirëqenien e qytetarëve dhe në raportet ndërkombëtare të vendit. “Programi politik me të cilin kemi garuar dhe që është udhëhequr nga Hamza, mbetet aktual edhe sot, ndoshta më shumë se kurrë. Ai parasheh rritje pagash e pensionesh, ulje të kostos së energjisë, liberalizim të ekonomisë dhe lehtësim të

kushteve për bizneset dhe sektorin privat”, u shpreh Krasniqi.

Krasniqi ka thënë se nuk do të provojnë të krijojnë qeverinë. Sipas Krasniqit, rruga e vetme janë zgjedhjet, meqë asnjëra parti nuk e ka shumicën. Ai ka thënë se presidentja Vjosa Osmani do të duhej t'i ftonte partitë qysh tash për diskutime. Madje, sipas tij, nuk ka nevojë të pritret fare 10 ditë, në mënyrë që të mos ketë vonesa tutje.



Oravi thotë se duhet të miratohet urgjentisht Kodi Civil

PRISHTINË, 28 TETOR - Ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, ka vizituar Akademinë e Drejtësisë dhe shënoi

Ditën Evropiane të Drejtësisë me gjyqtarët, prokurorët e sapoemëruar dhe drejtorin Enver Fejzullahu.

Diskutimet e tyre u përqendruan në pavarësinë dhe llogaridhënien gjyqësore. Ambasadori Orav theksoi se

duhet të miratohet urgjentisht Kodin Civil, i cili është çelësi për reformën e sundimit të ligjit të Kosovës dhe rrugën e integritimit.



RAHIMAJ KËRKON BASHKËPUNIM NDËRMJET DREJTORIVE DHE ME MENAXHERËT E KONTRATAVE



KAMENICË, 28 TETOR - Kryetari i komunës së Kamenicës, Kadri Rahimaj, së bashku me shefin e kabinetit Vaxhid Rexhepaj, menjëherë pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe certifikimit të rezultateve, kanë filluar angazhimet e para me një takim pune të përbashkët me drejtorët komunalë, menaxherët e kontratave, Zyrën e Prokurimit si dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa. Ky takim kishte për qëllim përparimin e deritanishëm të

punëve që janë duke u zhvilluar në kuadër të kontratave aktive të komunës, të cilat përfshijnë projekte të rëndësishme në fushën e investimeve kapitale, por edhe në atë të furnizimit me mallra dhe ofrimit të shërbimeve. Gjatë diskutimeve u shqyrtua dinamika e zbatimit të projekteve në terren, sfidat që janë hasur, si dhe hapat që duhen ndërmarrë për ta siguruar përfundimin me sukses të të gjithë projekteve. Rahimaj kërkoi një

bashkëpunim të ngushtë ndërmjet drejtorive dhe koordinim të vazhdueshëm me menaxherët e kontratave në mënyrë që të mos ketë vonesa në realizimin e projekteve që janë me rëndësi të drejtpërdrejtë për qytetarët e komunës së Kamenicës. Ai theksoi se vazhdimi i punimeve në terren dhe përfundimi i projekteve sipas afateve të përcaktuara mbetet prioritet i qeverisjes komunale, duke u siguruar që çdo investim publik të përfundojë me cilësi.

QENDRA RAJONALE E EKSELENCËS PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË NË KOSOVË SHËNON 25-VJETORIN E REZOLUTËS 1325 TË OKB-së

PRISHTINË, 28 TETOR - Në muajin që shënon 25-vjetorin e miratimit të Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, Qendra Rajonale e Ekselencës për Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë organizoi një konferencë njëditore në kuadër të së cilës u diskutuan kërcënimet e reja të shekullit XXI që po prekin gratë dhe vajzat në mbarë botën. Diskutimet përfshinë tema si dhuna me bazë gjinore e lehtësuar nga teknologjia, siguria

kibernetike, mbrojtja e të dhënave dhe sfida të tjera që përbëjnë forma të reja të rrezikut me të cilat përballen gratë dhe vajzat çdo ditë. Për t'iu përgjigjur këtyre sfidave, pjesëmarrësit nga vendet e rajonit diskutuan mënyrat për ta forcuar bashkëpunimin rajonal me qëllim fuqizimin e rolit, lidhshipit dhe vendimmarrjes së grave e vajzave, si në hapësirën digjitale, ashtu edhe në jetën publike e politike. Pjesa e fundit e konferencës iu

kushtua rrëfimeve personale të femijëve të luftës nga Kosova dhe Bosnjë-Hercegovina, histori prekëse të individëve që kanë përballuar traumën ndërbrezore dhe e kanë shndërruar dhimbjen në forcë e sukses. Këto histori frymëzuese dëshmojnë se ndërtimi i sistemeve të qëndrueshme mbështetëse për të mbijetuarit e luftës është thelbësor për krijimin e shoqërive më gjithëpërfshirëse, demokratike dhe më të zhvilluara.



FSK-ja GATI PËR REALIZIMIN E DV-DAY TË USHTRIMIT FUSHOR “UJKU SHIGJETË”



PRISHTINË, 28 TETOR - Komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, ka përcjellë nga afër demonstrimet finale të përgatitura për DV-Day, ku me këtë rast Komanda e Forcës Tokësore ka brifuar për rrjedhën e ushtrimit. Forca e Sigurisë së Kosovës përmes Regjimentit të Tretë të

Komandës së Forcave Tokësore është duke zhvilluar ushtrimin fushor “Ujku Shigjetë”. Ky ushtrim vjen pas një cikli të gjatë trajnimesh dhe përgatitjesh intensive në kuadër të procesit të validimit të regjimentit. Gjatë këtij ushtrimi po testohen aftësitë dhe kapacitetet luftarake të njësive në nivel taktik, me

qëllim që të vlerësohet gatishmëria operacionale dhe përmeshja e standardeve të kërkuara për validim. Përmes ushtrimeve të tilla, FSK-ja vazhdon ta demonstrojë përkushtimin ndaj ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe operacionale, në përputhje me standardet e forcave moderne të mbrojtjes.

Biblioteka “Fan S. Noli” në Gjilan pajiset me iPadë të rinj

GJILAN, 28 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me ambasadorin e Republikës së Bullgarisë në Kosovë, Hristo Kraevski, nënkryetaren Leonora Morina-Bunjakun, drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport, Kushtrim Zeqirin, dorëzuan në bibliotekën e qytetit “Fan S. Noli” në Gjilan iPadë të rinj. Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se në

bashkëpunim me Ambasadën e Bullgarisë në Kosovë po e çojnë përpara digjitalizimin e plotë të Bibliotekës “Fan S. Noli” në Gjilan përmes bashkëfinancimit të 150 iPadëve të rinj. “Kjo nismë do t’u mundësojë lexuesve tanë qasje në miliona libra elektronikë dhe artikuj shkencorë nga e gjithë bota”, tha Alban Hyseni. I pari i komunës theksoi se ky është hap i madh drejt një Gjilani që lexon, mëson dhe zhvillohet në

hap me kohën dhe me teknologjinë. Ambasadori i Republikës së Bullgarisë në Kosovë, Hristo Kraevski, tha se ndihet i lumtur që është për herë të dytë në Gjilan, këtë herë për projektin e digjitalizimit të bibliotekës së qytetit “Fan S. Noli” përmes tabletëve të mençur. Sipas ambasadorit, tabletët e mençur do të jenë në shërbim të atyre që janë të pasionuar pas leximit për qasje më të lehtë.



Muharremi: Kurti është tepër larg ta fitojë shumicën

PRISHTINË, 28 TETOR - Analisti politik Shenoll Muharremi ka komentuar situatën aktuale politike në vend, pas dështimit të Vetëvendosjes për ta formuar qeverinë 'Kurti 3. Ai ka vlerësuar se kjo parti është në një proces të rënies dhe nuk ka mundësi reale për ta fituar shumicën në zgjedhjet e ardhshme. "Kur nuk mundesh për ta formuar shumicën dhe qeverinë me gjithë ato 400 000 vota e 42.3 %, si mendon që mundesh për të fituar në zgjedhje të tjera, kur trendi yt i konfirmuar në nivel nacional është në rënie? Ky është një problem i madh në

kuptueshmërinë e Kurtit dhe LV-së, sepse kjo parti është në trend të rënies në nivel nacional. Ka qenë 50.2 % (kulmi në vitin 2021), prej nga ka filluar korrigjimi dhe tkurrja. Në zgjedhjet e 9 shkurtit ka qenë 42.3 %, ndërsa vetëm disa muaj më vonë ka rënë në matje në 40 %, pastaj 37 %", ka shkruar ai në "Facebook". Edhe në rast se LV-ja arrin ta mbajë përkrahjen aktuale, analisti thotë se ajo mbetet larg shumicës. "Por edhe nëse supozojmë që e ruan nivelin aktual të matjes së fundit në nivel nacional, përsëri LV-ja

është larg, tepër larg, për të fituar shumicën apo 51%. Kjo është e pamundur sipas trendeve dhe shumicës së indikatorëve racional dhe të besueshëm", ka thënë ai. Madje Muharremi ka përdorur një analogji, kur thotë se Kurti po humb. "Kjo tregon një situatë sikur në kazino kur ti, për shkak të moskujdesit dhe moskalkulimit të rrezikut, po humb gjithçka që ke fituar (si ndodhi me 400,000 votat e 9 shkurtit), por përsëri po shpreson se do të fitosh. Ti ke hyrë tashmë në tunel ku duket se nuk ka kthim mbrapa. Nga



kjo analogji kuptohet që pritjet apo teoria që LV-ja për të fituar shumicën në zgjedhjet e ardhshme janë krejtësisht joreale dhe të ndërtuara në kornizën e lakmisë (për

pushtet absolut), ngjashëm si në fushatën e 9 shkurtit", ka thënë ai. Sipas tij, Kurti dhe partia e tij nuk kanë probleme me numrat, por me qasjen politike.

ZYRTARIZOHET EMËRIMI I LIBURN ALIUT DREJTOR I PORTIT TË DURRËSIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 28 TETOR - Zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë në Shqipëri, Belinda Balluku, në një konferencë për medie ka zyrtarizuar emërimin e ish-ministrit Infrastrukturës së Kosovës, Liburn Aliu, në krye të Portit të Durrësit. Balluku ka thënë se ky port nuk do t'i shërbejë vetëm Shqipërisë, por do t'i shërbejë më gjerë Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut. "Porti i Durrësit për ne ka qenë një prioritet. Kemi kërkuar gjithmonë që të drejtohej nga profesionist jo vetëm që njohin transportin, por nga ana tjetër me aftësi negociuese me trupa ndërkombëtarë pasi Porti i ri i Durrësit parashikohet të jetë edhe një bazë e NATO-s", ka thënë Balluku. Ministrja Balluku ka shtuar se për këtë arsye dhe për shumë arsye të tjera zhvillimore drejtimi duhet të jetë në duar të mira dhe profesionale. "Për këtë arsye, duke qenë se Kreshnik Barjaktari, do të marrë një detyrë të re, stafetën do t'ia lë një tjetër kolegu të mirë që unë e kam njohur në punë dhe njerëzit njihen në punë. E kam njohur vite më parë kur kemi qenë



koleg të dy qeverive, dhe ky është Liburn Aliu, arktiket me profesion dhe me një karrierë të gjatë në politikë", ka deklaruar Balluku. Ish-ministri i Infrastrukturës së Kosovës, Liburn Aliu, ka folur pas zyrtarizimit të tij si drejtor i Portit të Durrësit, duke e cilësuar këtë si një detyrë të rëndësishme dhe sfiduese, që ka për synim modernizimin e portit më të madh në Shqipëri dhe rajon. Në fjalën e tij, Aliu shprehu

mirënjohje ndaj Qeverisë së Shqipërisë dhe zëvendëskryeminstres Belinda Balluku, e cila firmosi emërimin e tij në këtë detyrë. "Jam shumë i nderuar që jam sot këtu dhe jam i nderuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, nga zëvendëskryeministrja Balluku, për një detyrë që më është dhënë e besuar dhe që është mjaft sfiduese", ka thënë Aliu. Ai shtoi se ky besim përbën edhe një përgjegjësi të madhe, duke e

theksuar identitetin e tij si pjesë e të dy anëve të kombit. "Falënderoj Qeverinë e Shqipërisë, kryeministrin Edi Rama dhe zëvendëskryeministren Balluku që ma besuan këtë detyrë. Këtu më shihni që jam prej Kosovës, atje më shohin si të Shqipërisë - nuk është e lehtë, por gjithsesi këtë detyrë do ta bëjmë bashkë dhe shpresoj të kemi sukses", ka thënë ai. Duke e cilësuar Portin e Durrësit si një pasuri kombëtare e

rajonale, Aliu ka theksuar rëndësinë e tij për ekonominë e Kosovës dhe bashkëpunimin ndërshtetëror. "Porti i Durrësit vërtet nuk është vetëm port i Shqipërisë, është port i të gjithë shqiptarëve, i rajonit. Sot Kosova pothuajse pjesën dërrmuese të mallrave e merr nga ky port", ka thënë Aliu. Ai nënvizoi se modernizimi i portit është i domosdoshëm për ta bërë atë konkurrues në nivel rajonal.

Sindikata e Punëtorëve e RTK-së kërkon nga Kuvendi alokimin e buxhetit

PRISHTINË, 28 TETOR - Sindikata e Punëtorëve e Radio Televizionit të Kosovës (SPERTK) kërkon urgjentisht që Kuvendi i sapokonstituuar të ndërhyjë për ta siguruar alokimin e buxhetit për RTK-në në mënyrë që të shmangët përsëritja e situatës së muajit gusht, kur punëtorët mbetën pa paga dhe funksionimi i transmetuesit publik u rrezikua. Sipas një njoftimi për medie bëhet me dije se SPERTK ka

bërë kërkesë zyrtare në adresë të Bordit dhe Menaxhmentit të RTK-së në fillim të muajit tetor lidhur me pagesat e punëtorëve, por deri më sot nuk ka marrë asnjë përgjigje. "Prandaj, kërkojmë publikisht transparencë dhe njoftim të qartë për gjendjen e pagave. Sindikata nuk paragjykon asnjë situatë lidhur me buxhetin, por kërkon përgjegjësi dhe transparencë për këtë çështje, pasi paga është e drejtë ligjore dhe kërkesë legjitime për

punën që kanë kryer të gjithë punonjësit e RTK-së", thuhet në njoftim. Ndërkaq, siç thuhet në njoftim, aktualisht RTK gjendet në procese të rëndësishme programore dhe zhvillimore, ndërsa mungesa e buxhetit rrezikon seriozisht vazhdimin e këtyre projekteve dhe stabilitetin e institucionit publik. "SPERTK kërkon nga Kuvendi të veprojë menjëherë për: Alokimin e buxhetit 2025 për RTK-në, për të shmangur

çdo vonesë në paga; Kompletimin urgjent të Bordit të RTK-së, për të mundësuar funksionimin me kuorum të plotë; Rritjen e buxhetit për vitin 2026, për zhvillim institucional dhe programe cilësore sipas standardeve evropiane. Sindikata e Punëtorëve të RTK-së do të dalë shumë shpejt me qëndrime dhe veprime ligjore, nëse mungesa e përgjegjësisë institucionale vazhdon dhe punëtorët mbeten pa trajtim të



dinjitetshëm financiar", thuhet në njoftimin e kësaj sindikate. Më tutje, siç bëhet me dije në njoftim, ata kërkojnë ndërhyrje urgjente të Kuvendit për të garantuar stabilitet financiar, funksionalitet institucional dhe mbrojtje të të drejtave të punëtorëve të RTK-së.

HAKI SHATRI: NËSE NGA 1 JANARI S’KA QEVERI TË RE, NUK DO TË KETË KUSH TA PROPOZOJË VAZHDIMIN E SHPENZIMEVE BUXHETORE



PRISHTINË, 28 TETOR - Dështimi për formimin e një qeverie të re ka rritur rrezikun që Kosova të hyjë në vitin 2026 pa buxhet. Për ekspertin e financave, Haki Shatri, shteti rrezikon të falimentojë, teksa mund të mos ketë para as për paga e as për pensione e shtesa për fëmijët në fillimvitin e ardhshëm. Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, Shatri thotë se vetëm një qeveri me kompetenca të plota mund të ndërmarrë nisma për ndryshimin e Ligjit për Buxhetin, apo për vazhdimin e ndarjeve buxhetore edhe për muajt e parë të 2026-s. “Nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje që të funksionalizohet një e dymbëdhjeta e buxhetit në janar, edhe tërmet të ketë, nuk guxon askush të ndërmarrë asgjë”, shprehet ai. Ish-ministri i Ekonomisë dhe Financave thotë se pa një qeveri të re, në janar s’do të ketë para as për ushtrinë e policinë.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, nuk i siguroi votat e nevojshme për krijimin e qeverisë se re. Më 30 tetor është afati i fundit për miratimin e buxhetit nga qeveria, ndërsa Kuvendi duhet ta votojë atë deri më 31 dhjetor. Çfarë pasojash ekonomike mund të ketë, nëse ky proces nuk përmbyllet brenda afateve?

Haki Shatri: Afatet e rregullta për procedurat e miratimit të buxhetit në Kuvend janë këto. Në rast se nuk kemi një qeveri të plotfuqishme dhe me mandat të plotfuqishëm, e cila

mund të procedojë një dokument me karakter ligjor, siç është buxheti, atëherë nuk ka kush ta dërgojë në Kuvend projektligjin për buxhetin, edhe nëse ai është përgatitur nga stafi civil brenda Ministrisë së Financave, apo nga organet kompetente për përgatitjen e tij. Në këtë situatë nuk ka kush ta propozojë ndryshimin e ligjit aktual për buxhetin. Si variant i mundshëm është një e dymbëdhjeta e buxhetit të këtij viti, për muajt janar dhe shkurt të vitit të ardhshëm. Proceduralisht, është propozim për ndryshimin e ligjit për buxhetin e këtij viti, pra ndjek të njëjtën procedurë sikurse miratimi i vetë ligjit për buxhetin. Nëse nga 1 janari s’ka qeveri të re, nuk do të ketë kush ta propozojë këtë vazhdim të shpenzimeve buxhetore dhe të parasë publike.

Në situatën aktuale, a ka të drejtë ligjore qeveria në detyrë ta propozojë vazhdimin e shpenzimeve edhe për dy muajt e parë të vitit të ardhshëm?

Haki Shatri: Në ligjin për buxhetin shkruan se [të gjitha ndarjet buxhetore për vitin fiskal 2025 skadojnë] më 31 dhjetor 2025. Qeveria e plotfuqishme del me një vendim që data 31 dhjetor të ndryshohet, dhe merret vendim që ligji për buxhetin 2025 vazhdon të zbatohet edhe në muajt janar dhe shkurt të vitit 2026, që i bie ndryshim i ligjit, do të thotë procedurë e njëjtë me miratim të ligjit. Qeveria [në detyrë e Kosovës] nuk e ka këtë

të drejtë. Po flas tashmë jashtë përgjegjësisë profesionale që e kam, vetëm nëse deputetët i mbyllin sytë për arsye se iu cenohet paga ose disa interesa personale, dhe thonë “hajt, edhe pse nuk është në pajtim me ligjin, po e gëlltisim këtë variant”. Por, kjo është e jashtëligjshme. E them me përgjegjësi të plotë: është e jashtëligjshme.

Pse mendoni se është kundërligjore?

Haki Shatri: Sepse kjo qeveri nuk ka kompetenca të propozojë as ligj dhe as ndryshim të ligjit. Kjo ka kompetencë vetëm t’i zbatojë ligjet që janë në fuqi.

Deri kur kemi buxhet, në situatën që jemi, pra me qeveri në detyrë?

Haki Shatri: Në situatën që jemi, deri më 31 dhjetor buxheti është i aprovuar. Ai zbatohet, procedohen pagat, pensionet, të gjitha pagesat që janë të papara me Ligjin e Buxhetit vazhdojnë në mënyrë normale, si me qeveri, si pa qeveri. Sepse nuk ka nevojë që ministri të merret më me atë punë. Merret Thesari, merret Drejtoria e Buxhetit, dhe ai vetëm zbatohet. Prej 31 dhjetorit, ky ligj shfuqizohet. Për ta bërë të plotfuqishëm këtë ligj pas 1 janarit, duhet të ndryshohet ligji. Ndryshimi është formal, me dy fjali ndryshohet, por është procedurë ligjore. Një vendim i qeverisë për të vazhduar këtë buxhet edhe vitin tjetër nuk është konform me

ligjin, sepse qeveria në detyrë nuk ka kompetencë. Vetëm një qeveri e plotfuqishme mund t’i propozojë Kuvendit që buxheti të vazhdohet edhe për një muaj, sipas nevojës, sikurse që ka ndodhur edhe në të kaluarën.

Por, Kosova tashmë ka Kuvendin e konstituuar. A ka ndonjë mekanizëm brenda këtij organi, që ta mundësojë vazhdimin e buxhetit edhe për dy muajt?

Haki Shatri: Unë, me sa di, ligjet që janë në fuqi e parashohin mundësinë e vazhimit, kur ka qeveri të plotfuqishme. Pra, që [ekzekutivi] t’ia propozojë Kuvendit, e më pas Kuvendi të marrë vendim.

Kosova po përballlet me mundësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshme, të cilat vetë kanë afate. Sa pritet të ndikojë kjo situatë në stabilitetin financiar të vendit, dhe në procesin e planifikimit buxhetor për vitin 2026?

Haki Shatri: Njerëzit që janë liderë të vendit, po flas për të gjitha partitë, duhet të mendojnë me kohë, ta menaxhojnë kohën dhe rrethanat. Nuk është dashur të humbet një vit, për të ardhur fundi i vitit dhe të mos ketë institucione të konsoliduara. Normalisht që tani kemi probleme të kësaj natyre, me buxhet. Brenda këtij viti mund të ndodhë që të kemi edhe zgjedhje të jashtëzakonshme, por qeveri të re nuk do të mund të ketë. Unë nuk e di a ka të drejtë Kuvendi t’i japë mandat Qeverisë, me një vendim të

veçantë, për të marrë vendim për buxhetin.

Por, sipas jush, cila është zgjidhja, pasi për një mandat e keni udhëhequr Ministrinë e Financave në Qeverinë e Kosovës?

Haki Shatri: Sipas përvojës që kam pasur edhe në Kuvend, Kuvendi mund të hyjë pak “në të kuqen”, nëse pajtohen deputetët me shumicë votash, t’i kërkojnë Qeverisë që të marrë vendim lidhur me buxhetin. Përndryshe, tjetër rrugë nuk ka. Thjesht, jam i trishtuar deri ku ka ardhur puna. Të vijë situata, pas 25 vjetësh çlirim, të falimentojë shteti, të mbyllet shteti, të mos funksionojë. Nëse më 1 janar nuk kemi një vendim të plotfuqishëm për të vazhduar një e dymbëdhjeta e buxhetit të këtij viti, nuk do të ketë paga, pensione, shtesa të fëmijëve, nuk do të ketë më para për asnjë lloj shpenzimi, as për lëndë djegëse sa për të futur çelësin një veture [qeveritare] për ta ndezur.

Po për rastet emergjente, a ka hapësirë ligjore?

Haki Shatri: Nëse nuk gjendet ndonjë zgjidhje që të funksionalizohet një e dymbëdhjeta e buxhetit në janar, edhe tërmet të ketë, nuk guxon askush të ndërmarrë asgjë.

As për ushtrinë apo sektorë të tjerë të caktuar të rëndësishëm?

Haki Shatri: As për ushtri, as për polici, as për asgjë. Buxheti është ligj të cilin nuk guxon askush ta shkelë.

A MUND TA ARRIJË TRUMP PAQEN E PËRJETSHME NË GAZË?



Nga Joschka FISCHER

Luftërat e kaluara në Lindjen e Mesme jo vetëm që kanë sjellë vuajtje të mëdha njerëzore, por kanë krijuar edhe rrugë të reja drejt paqes. E njëjta gjë vlen për luftën në dhe rreth Gazës. Izraeli dhe Shtetet e Bashkuara e kanë dobësuar ndjeshëm, ndoshta edhe në mënyrë vendimtare, të ashtuquajturin Bosht të Rezistencës – të udhëhequr, financiar dhe armatosur nga Irani – si dhe programin bërthamor të Iranit. Udhëheqësit e Hezbollahut (në Liban) dhe të Hamasit (në Gazë) janë eliminuar dhe regjimi i Assad-it në Siri është rrëzuar. Lindja e Mesme tani është një vend ndryshe dhe Irani me Boshtin e tij të Rezistencës janë ndër humbësit më të mëdhenj. Lufta në Gazë ka përfunduar, të paktën për momentin. Të gjithë pengjet ende gjallë që mbaheshin nga Hamasi që nga 7 tetori 2023 janë kthyer në Izrael. Gaza mund të jetë pothuajse tërësisht e shkatërruar, por, për momentin, armiqësitë formale kanë

pushuar. Duke marrë parasysh përmasat e tragjedisë humanitare atje, vetëm kjo është një arritje e madhe. Presidenti amerikan Donald Trump dhe negociatorët e tij meritojnë falënderime dhe njohje për këtë arritje. Por mbetet ende pjesa më e vështirë e projektit për të vendosur atë që Trump e quan “paqja e përjetshme”. Situata kërkon vendime të guximshme politike nga të gjitha palët – jo vetëm gjeste retorike, por ndryshime reale në terren – dhe këto duhet të ndodhin shpejt. Për më tepër, duhet të arrihet një plan konkret veprimi nëse paqja në Lindjen e Mesme, apo edhe menaxhimi i konfliktit, do të ketë ndonjë shans. Paqja do të vijë vetëm nëse dy popujt që pretendojnë të njëjtën tokë janë të gatshëm të pajtohen. A ekziston një shumicë në Izrael për këtë, apo në anën palestineze? A mundet Trump t’i detyrojë të dyja palët të ndjekin rrugën e paqes dhe a do të ketë SHBA-ja qëndrueshmërinë për ta çuar atë deri në fund? Pa një angazhim të të gjitha palëve për të hequr dorë për-

fundimisht nga dhuna dhe pa një rikthim te njohja e ndërsjellë e së drejtës së ekzistencës së njëra-tjetrës – me fjalë të tjera, një rikthim te Marrëveshjet e Oslos – nuk mund të ketë paqe. A është kjo e mundur me kryeministrin izraelit Benjamin Netanyahu, i cili e ka refuzuar zgjidhjen me dy shtete? Ajo çka nevojitet më me urgjencë është një proces politik me një afat kohor dhe hapa të dakorduar. Pa këtë, nuk do të ketë paqe dhe as gatishmëri nga ana e komunitetit ndërkombëtar për të financuar rindërtimin e Gazës – që është një tjetër përparësi urgjente. Ç’do të ndodhë me dy milionë palestinezët në Gazë të cilët janë pa një çati mbi kokë dhe pa kujdes shëndetësor? Nuk është shenjë e mirë për të ardhmen që një popullsi dërrmuese e re është privuar nga vendet e punës, arsimit dhe trajnimit. Ai është terreni ideal për përhapjen e islamistëve radikalë si Hamasi ose grupe të tjera terroriste që janë në kundërshtim me kauzën e paqes.

Por kush do ta qeverisë dhe administrojë Gazën, apo do të ofrojë siguri dhe do ta çarmatosë Hamasin? Kush nga ana palestineze mund ta shndërrojë trillimin diplomatik të një “Shteti të Palestinës” në realitetin e një fqinji paqësor dhe të sigurt të Izraelit? Dhe deri në ç’masë do të duhej të çmilitarizohej një shtet i tillë? Qeveritë arabe nuk kanë gjasa të angazhohen materialisht ose politikisht në një plan të cilit i mungon një proces i besueshëm për krijimin e një shteti palestinez – edhe pse lufta në Gazë ka treguar se një çështje palestineze e pazgjidhur mund të ketë pasoja afatgjata dhe kërcënuese edhe për ta. Pastaj është Izraeli. A është qeveria aktuale e përgatitur të bjerë dakord për ndarjen e territorit historik të Mandatit të Palestinës – duke përfshirë Bregun Perëndimor dhe Gazën? Po çështja jashtëzakonisht e vështirë e Jerusalemit dhe çështja edhe më e ndërlikuar e Malit të Tempullit? Pikërisht sepse ky rajon, dhe veçanërisht Jerusalemi, ka qenë gjith-

monë i lidhur me tre fetë abrahamike – Judaizmin, Krishterimin dhe Islamin – përfaqësuesit e secilës do të luajnë gjithmonë një rol vendimtar në negociatat politike. Sidomos drejt fundit të bisedimeve të mundshme për paqe, mesazhet dhe premtimet fetare nga autoritetet më të larta (dhe mënyra se si interpretohen ato) do të jenë thelbësore. Nëse Trump e mendon vërtet atë që thotë, ai ka marrë përsipër një barrë të madhe. Ai bëri fushatë me një premtim për t’i dhënë fund rolit të Amerikës si xhandari i botë, por tani po merr përsipër atë që është ndoshta sfida më e vështirë në politikën ndërkombëtare bashkëkohore. SHBA-ja, me fuqinë e saj të jashtëzakonshme, është e vetmja fuqi që ka një shans për të pasur sukses. Por a ka Trump durimin dhe qëndrueshmërinë që kërkon kjo detyrë? Dështimi do ta zhyste Lindjen e Mesme në trazira edhe më të thella. Evropa, fqinja e rajonit, duhet ta ketë gjithmonë parasysh këtë.

KUPTIMI SI RREZIK DHE BOSHLLËKU SI SHPËTIM! NJË REFLEKTIM MBI PSIKANALIZËN LAKANIAKE DHE AKTIN E FUNDIT

Në psikanalizën lakaniake, çdo formë e plotë, çdo gestalt, sado produktive apo krijuese të duket, është në thelb burim i huajësimi.

Sepse gjithçka që formohet rreth nesh, çdo identitet që ndërtojmë përmes gjuhës dhe imazheve, është një rrjet signifikantësh që na përcaktojnë, por njëkohësisht na robërojnë. Në to ne njohim veten, por në to edhe humbemi.

Për këtë arsye, qëllimi i psikanalizës, sipas Lacanit, nuk është të japë kuptim, por ta zhveshë subjektin prej kuptimit. Ta shkëpusë nga ajo ndjesi e rreme se “jemi” ajo që na emërton, që na jep shoqëria, gjuha, morali. Sepse, siç thotë Miller, në thelb “psikanaliza është një zbulim i asgjësë; operacioni analitik synon asgjënë vetë.”

Në atë asgjë, në atë boshllëk të zhveshur nga çdo përcaktim, njeriu përballet me veten për herë të parë.


Psikanalisti i famshëm francez, Zhak Lakanin, e shpjegon këtë me një brutalitet poetik që të trondit: “Ka fjalë që futin në trup përfaqësimet idiote,” –

thotë ai – “dhe aty e keni çelësin e çështjes: aty ndodhet imagjinaria. Dhe për më tepër, ajo na e vjell një të vërtetë, një të vërtetë më shumë.”

Kjo “e vërtetë” që na vjell imagjinaria është e rreme, sepse lind nga fjala, nga ideja e kuptimit, nga nevoja për të mbushur boshllëkun. Por, për Lacanin, shpëtimi fillon vetëm kur njeriu pranohet boshllëkun si pjesë të vetes, si mungesë që nuk kërkon më të mbushet.

Zigmund Freudi, shumë më herët, e kishte parandjerë këtë kur në “Pakënaqësia në kulturë” paralajmëronte për rrezikun e super-unit që përthith pulsionet e id-it. Kur morali, ligji, ideali përvetëson dëshirat e pavetëdijshme, njeriu shndërron në një qenie të ndarë, të mbytur nga ndjenja e fajit. “Heqja dorë nga kënaqësia e instinkteve,” shkruan ai, “nuk mjafton, sepse dëshira vazhdon të ekzistojë dhe nuk mund të fshihet para super-unit. Ndjenja e fajit, pra, nuk do të pushojë së shfaquri, pavarësisht nga heqja dorë e bërë.”

Ky është rrethi tragjik i njeriut modern: sa më shumë që



mohon dëshirën, aq më shumë e ndien fajin; sa më shumë që kërkon të jetë “i mirë”, aq më shumë e përjeton veten si të pamjaftueshëm.

Në skajin ekstrem të këtij faji që s’gjen shlyerje, qëndron akt i vetëvrasjes.

Në kundërshtim me mendimin popullor, Lacani e përmbys arsyetimin tradicional: “Njerëzit nuk vetëvriten sepse jeta nuk ka kuptim, por sepse s’gjen ka tepër kuptim.”

Sepse kuptimi është burimi më i rrezikshëm i huajësimi. Ai ngushton botën, e redukton në

një skemë për ta përballuar, e mbyll në një formulë që vret çdo spontanitet.

Kuptimi i tepërt bëhet peshë, bëhet burg, bëhet përbindëshi që kërkon gjithnjë më shumë nga njeriu, derisa super-unit, i etur për përsosmëri morale e për sakrificë, e shtyn drejt absolutit të vdekjes. Sepse, siç thotë Lacani, “çdo pulsion është pjesërisht një pulsion vdekjeje.”

Kështu, në mënyrë paradoksale, Lacani e sheh vetëvrasjen si një akt të arritur, jo në sensin moral apo heroik, por si një

përmushje e plotë e pulsionit që kërkon shuarjen.

Një akt që tejkalon kufijtë e kuptimit, sepse është përtej gjuhës, përtej ligjit, përtej tjetrit.

Një akt ku subjekti, për herë të fundit, bëhet zot i trupit të vet, i mungesës së vet, i asgjësë së vet.

Por në thelb, ajo që Lacani kërkon nuk është vdekja, por vetëdija për boshllëkun. Ai fton subjektin të mos e mbushë mungesën me kuptime të rreme, as me idealë të huaj, por ta pranojë mungesën si themel të ekzistencës. Sepse vetëm atëherë, kur njeriu nuk e kërkon më Tjetrin për ta përcaktuar, mund të përballet me veten e vet, me barrimin e Tjetrit – S(A) – dhe të njohë lirinë që lind në zemrën e mungesës.

Në këtë kuptim, psikanaliza bëhet një zbulesë e asgjësë, një mënyrë për ta kthyer boshllëkun në vend të lindjes së mendimit, jo të vdekjes.

Dhe ndoshta këtu qëndron revolucionin i saj më i thellë: që njeriu nuk shpëton duke gjetur kuptim, por duke mësuar të jetojë pa të. /ora/

RIMBAUD, RINIA E TRAZUAR E NJË POETI TË LINDUR DHE ARRATIA NGJA VETVETJA!

Arthur Rimbaud ishte poeti që e shpiku vetveten, pastaj e shkatërroi. Një shpirt që kërkoi gjithçka, pastaj u largua nga gjithçka. Një djalosh që shkroi poezi për të shpëtuar, por që kuptoi se as poezia nuk mund ta shpëtonte nga vetja. Por në historinë e letërsisë botërore, emri i Arthur Rimbaud zë një vend të veçantë, ndoshta unik. Ishte një meteor që ndriçoi fuqishëm qiellin poetik francez për një kohë të shkurtër, për të zhdukur më pas po aq papritur sa u shfaq. Ndërsa shumica e shkrimtarëve ndjekin një rrugë të gjatë krijuese, Rimbaud e nisi dhe e përfundoi karrierën e tij letrare para se të mbushte 21 vjeç.

Por ajo që la pas është një trashëgimi e fuqishme që vazhdon të ndikojë poetët, artistët dhe mendimtarët edhe sot. Arthur Rimbaud lindi më 20 tetor 1854 në Charleville, një qytet i vogël në verilindje të Francës. Babai i tij ishte oficer ushtarak, ndërsa nëna, një grua e rreptë dhe konservatore, ishte figura dominante në jetën e tij të hershme, pasi i ati u largua nga familja që kur Arthur ishte vetëm gjashtë vjeç. Që në fëmijëri, Rimbaud tregoi shenja të një inteligjence të jashtëzakonshme. Ai mësoi latinishten dhe greqishten e lashtë, shkroi poezi që në moshën dhjetëvjeçare dhe fitonte çmime në shkollë. Por pas vitit 1870, me shpërthimin e

Luftës Franko-Prusiane dhe përmbysjen e Perandorisë së Dytë Franceze, Rimbaud nisi të rebelohej — jo vetëm kundër autoriteteve, por edhe kundër çdo norme shoqërore e kulturore.

POETI SI VIZIONAR

Në një letër të famshme drejtuar Paul Demyen më 1871, Rimbaud shkruan: “Unë është një tjetër” (Je est un autre). Kjo frazë u bë një nga manifestet më të guximshme të modernizmit letrar. Për Rimbaud, poeti nuk ishte thjesht një njeri që përshkruan botën; ai ishte një “shikues” (voyant), që e shndërron veten në një enë të përjetimeve të pas-tras, të pavetëdijshme dhe ndonjëherë të çmendura, në mënyrë që të arrijë në thelbin e së vërtetës. Poezia për të nuk ishte zbulim apo ndjeshmëri estetike. Ishte eksperiment. Ishte shpërthim. Ishte revoltë. Rimbaud filloi të shkruajë intensivisht rreth moshës 16 vjeç.

Vepër e tij më e njohur, “Une Saison en Enfer” (Një stinë në ferr, 1873), është një poemë në prozë që ndërthur rrëfimin personal, reflektimin filozofik dhe thyerjen e çdo konvence letrare. Libri përshkruan me intensitet rrëzimin shpirtëror dhe eksperimentet e poetit me drogën, seksin, filozofinë, madje dhe mistikën. Pas kësaj vepre, ai

shkroi “Illuminations” (Iluminacionet), një përmbledhje tekstesh poetike që i ngjajnë një psikodelie verbuese. Këto poema të lirshme, të ç’strukturuara dhe të mbushura me imazhe surrealiste, përbëjnë kulmin e gjenisë së tij poetike dhe kanë ndikuar drejtpërdrejtë poetë të mëvonshëm si Paul Valéry, André Breton, Allen Ginsberg e shumë të tjerë.

DASHURIA E SHKATËRRIMIT


Në vitin 1871, Rimbaud u njoh me poetin Paul Verlaine, i cili do të bëhej dashuria e tij fatkeqe dhe partneri në një marrëdhënie të dhunshme dhe kaotike. Verlaine, i martuar dhe me fëmijë, la familjen për të ndjekur Rimbaud në një udhëtim të shfrenuar përmes Brukselit e Londrës, ku ata jetuan në mjerim, por edhe krijuan disa nga veprat më të rëndësishme të tyre. Marrëdhënia përfundoi në mënyrë tragjike kur Verlaine, në një moment xhelozie e dëshpërimi, qëlloi me armë Rimbaud-in dhe u dënua me dy vjet burg. Ky episod i errët shënoi fundin e lidhjes së tyre dhe gjithashtu fillimin e fundit të jetës letrare të Rimbaud-it. Pas vitit 1875, Rimbaud ndaloi së shkruari poezi përgjithmonë. Ai mori një drejtim krejtësisht të papritur: u bë udhëtar, tregtar



dhe aventurier. Shkoi në Itali, Gjermani, Qipro, Egjipt dhe përfundimisht në Afrikë, ku jetoi për vite me radhë si tregtar armësh, eksplorator dhe administrator. Kjo periudhë është e mbuluar me mister. Poeti që dikur ëndërronte për shenjtërimin përmes shkatërrimit, tashmë i ishte dorëzuar materializmit dhe arratisjes totale nga Evropa dhe vetvetja. Ai dukej sikur kërkonte të zhdukte çdo gjurmë të poetit që kishte qenë.


RILINDJA SI MIT

Rimbaud vdiq më 10 nëntor 1891, në moshën 37-vjeçare, Marsejë, pas një sëmundjeje të rëndë që çoi në amputimin e njëres këmbë. Vdekja e tij shënoi fundin e një jete plot kontradiktë, por fillimin e një legjende që nuk u shua kurrë. Në shekullin XX, ai u zbulua dhe u rivlerësua



nga surrealistët, ekzistencialistët, bitnikët dhe shumë të tjerë. Vepra e tij u bë gur themeli për çdo poet që kërkonte të shkatërronte status quonë dhe të krijonte një gjuhë të re për të shprehur ankthin, ekstazën dhe rebelimin modern. Arthur Rimbaud është më shumë se një poet. Ai është simboli i përhershëm i rinisë që sfidon, që nuk pranohet të nënshtrohet, që digjet për të lënë një dritë të pashlyeshme pas.

Ai mbetet i përjetshëm jo sepse shkroi shumë, por sepse guxoi të shkruajë si askush tjetër, për të mos shkruar më kurrë. Në një kohë kur letërsia ndonjëherë rrezikon të bëhet rutinë, Rimbaud na kujton se fjala poetike është një akt ekstrem, një akt lirie totale. Dhe se ndonjëherë, për të shpëtuar shpirtin, duhet të flijosh gjithçka tjetër edhe poezinë vetë.



KOSOVA U17 REALIZON FITORE BINDËSE NDAJ AZERBAJXHANIT

PRISHTINË, 28 TETOR - Kombëtarja e Kosovës U17 në konkurrencën e vajzave ka vazhduar me formë të shkëlqyer në kualifikimet për Kampionatin Evropian 2026, duke regjistruar fitoren e dytë radhazi në Grupin B të Ligës B. Ndeshjet e këtij grupi janë duke u zhvilluar në Moldavi, ndërsa pas triumfit në ndeshjen hapëse ndaj Moldavisë vajzat dardane të udhëhequra nga përzgjedhësja Sanije Krasniqi kanë shënuar fitore plotësisht të merituar ndaj Azerbajxhanit me rezultat 6:0.

Kosova ka dominuar nga fillimi deri në fund, duke imponuar lojën e saj dhe duke krijuar shumë raste shënimi. Golat për Dardanet U17 i kanë realizuar



Anisa Meha (8', 57'-p), Reina Halili, Jonida Godeni (33'), Krenare Kelmendi (34') dhe Ema Maliqi (48'). Pas ndeshjes, përzgjedhësja Sanije Krasniqi

është shprehur tejet e kënaqur me performancën e vajzave. "Ishte një ndeshje shumë e mirë nga ekipi ynë. E dominuam kundërshtarin në

çdo aspekt të lojës dhe e menaxhuam ndeshjen me pjekuri. Jam e kënaqur që vajzat reagues mirë pas ndeshjes së parë dhe i përmirësuan dobësitë që i kishim vërejtur ndaj Moldavisë, ku humbëm shumë raste shënimi. Sot treguam efikasitet të lartë dhe disiplinë taktike. Më gëzon fakti që të gjitha vajzat patën mundësi të luajnë dhe ta japin kontributin e tyre. Tani do të fokusohemi në ndeshjen e fundit ndaj Uellsit, ku do ta kërkojmë maksimumin për ta siguruar kualifikimin tutje", ka thënë Krasniqi.

Ndërsa Anisa Meha, e cila ka realizuar dy gola në këtë fitore, ka vënë në pah frymën ekipore në arritjen e këtij suksesi. "Ishte

një ndeshje shumë e mirë për ne. Luftuam me zemër dhe për njëra-tjetrën në çdo moment të lojës. Ky përkushtim na ndihmoi ta arrijmë rezultatin që e dëshironim. Jam shumë e lumtur për dy golat e shënuar, mbi të gjitha për mënyrën se si luajti ekipi. Sot u treguam më të qeta dhe më efikase para portës kundërshtare. Besoj se edhe në ndeshjen e fundit kundër Uellsit do të japim maksimumin dhe do të arrijmë një tjetër fitore për ta përmbyllur këtë fazë me sukses", ka thënë ajo. Do të jetë pikërisht ndeshja e fundit Kosovë - Uells që do të përcaktojë se cila prej këtyre dy kombëtareve do ta arrijë pozitën e parë në grup.

FITOJNË BALLKANI DHE DUKAGJINI

SUHAREKË/ KLINË, 28 TETOR - Kanë përfunduar dy ndeshjet e para të javës së 11-të të Superligës së Kosovës në futboll. Ballkani ka shënuar një fitore të thellë në udhëtim, duke mposhtur Malishevën me rezultat 5-0. Skuadra e drejtuar nga Orges Shehi është kthyer te fitorja pas barazimit në shtëpi ndaj Gjilanit, duke treguar forcën

në duel me malishevasit. Pjesa e parë e ndeshjes ishte e ekuilibruar, por me një avantazh të lehtë për mysafirët. Golin e epërsisë e ka realizuar Almir Kryeziu në minutën e 7 nga pika e bardhë, duke i çuar therandasit në pushim me shifrat 0-1. Në pjesën e dytë, Ballkani ka dominuar plotësisht lojën. Bleart Tolaj ka shënuar dy

herë (47' dhe 61') për ta thelluar rezultatin në 0-3, ndërsa Giovanni Ribeiro (70') dhe Valentin Serebe (76') kanë vulosur triumfin me 0-5. Pas kësaj fitoreje, Ballkani ngjitet në vendin e dytë me 22 pikë, tri më pak se liderja Prishtina që ka një ndeshje më pak të zhvilluar. Në anën tjetër, Malisheva mbetet në pozitën e gjashtë me 13 pikë. Ndërsa

pas katër ndeshjeve pa fitore, Dukagjini u është kthyer fitoreve, duke triumfuar me rezultat të pastër 0-2 në udhëtim ndaj Gjilanit. Me këtë fitore të rëndësishme, Dukagjini ngjitet në vendin e katërt me 17 pikë, ndërsa Gjilani mbetet në pozitën e tetë me 11 pikë. Kujtojmë se sot (e mërkurë) në orën 13:00 do të luhen



ndeshjet Drenica - Drita, Llapi - Prishtina dhe Ferizaj - Prishtina e Re.

VOLEJBOLLISTJA E DINAMOS E AKUZON FEDERATËN PËR DISKRIMINIM: JAM 100 PËR QIND FEMËR

TIRANË, 28 TETOR - Volejbollistja braziliane e ekipit të Dinamos, Nayara Ferreira, ka reaguar pas suspendimit të saj, pasi Federata Shqiptare i ka kërkuar ta vërtetojë gjininë përmes analizës së gjakut. Ajo mes lotësh ka treguar se po kalon një situatë shumë të vështirë në karrierën e saj sportive. "Kjo është një situatë shumë e vështirë për mua. Është hera e parë që përjetoj diçka të tillë në gjithë



karrierën time. Luaj volejboll që nga mosha 12-vjeçare", ka deklaruar ajo, duke e vlerësuar si diskriminues pezullimin e saj. "Jeta ime është private dhe unë jam

person që i mbaj gjërat për vete. Ajo që po ndodh tani me mua është diskriminim. Nuk e pranoj këtë. Nuk më kanë dhënë asnjë arsye ligjore pse e bënë këtë. Kur pyeta një zyrtar të federatës, më tha se 'është dokument privat'. Po çfarë është private për dikë tjetër në lidhje me jetën time?", ka thënë ajo në një intervistë për "Top Channel". Brazilianja ka thënë se ndihet e shkatërruar nga mënyra si është trajtuar dhe se gjatë gjithë karrierës ka

luajtur në shumë vende pa u përballur kurrë me diçka të tillë. Më tutje, Ferreria ka deklaruar se është "100 për qind grua" dhe nuk ka pse të dëshmojë këtë para askujt. "Jam 100 për qind femër, dhe kjo është diçka që nuk kam pse ta shpjegoj. Ju vetëm keni parë si vishem, fizikun tim, flokët, tatuazhet. Ajo që keni bërë është diskriminim. Nuk e di si mund të flejë i qetë presidenti i federatës suaj me këtë në ndërgjegje. Nuk kam

fjetur, nuk kam ngrënë, nuk kam pirë as ujë. Prandaj, faleminderit Federatës Shqiptare që ma bëtë këtë!", ka thënë ajo me ironi. Në fund të kësaj interviste ajo është shprehur se e vërteta do të dalë në dritë dhe se nuk ka asgjë për të fshehur. Në mediet shqiptare ditë më parë është raportuar për suspendimin e Nayara Ferreras, me kërkesë të Federatës Shqiptare të Volejbollit, në pritje të verifikimit të dokumentacionit të saj.

Bayern Munichu rivalizon fort Barcelonën për Fisnik Asllanin

MUNICH, 28 TETOR - Bayern Munichu ka vendosur Fisnik Asllanin në listën e shkurtër të transferimeve, duke e parë si një alternativë të fortë për Harry Kanen që nga sezoni 2026/27. Bayern Munich, nën drejtimin e Eberl dhe Freund, janë shumë të impresionuar nga zhvillimi dhe

profili i sulmuesit 23-vjeçar dhe tashmë janë të informuar për klauzolën e tij të largimit që aktivizohet në verën e ardhshme, shkruan Florian Plettenberg. Asllani, aktualisht te TSG Hoffenheim, ka bërë të qartë se dëshiron të largohet pas këtij sezoni. FC Barcelona është

ndër klubet e interesuara, si dhe tri skuadra të Ligës Premierë: Aston Villa, Chelsea dhe Tottenham. Pothuajse të gjitha klubet kryesore nga Gjermania, Anglia, Spanja dhe Italia janë duke e ndjekur me kujdes lojtarin. 23-vjeçari ka shënuar 6 gola dhe ka

dhënë 2 asiste deri tani në të gjitha garat, duke treguar potencialin e tij si një sulmues i klasës së parë. Bayern Munich duket se po planifikon të sigurojë një lojtar që mund të bëhet pjesë kyçe e projektit të tyre sulmues për vitet e ardhshme.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Per Ty Media” SH.P.K. pronar Lirim Ramushi me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812086553 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Per Ty Media” D.O.O. Lirim Ramushi Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812086553 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Per Ty Media” L.L.C. with owner Lirim Ramushi with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 812086553 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Nezir Iberdemaj përfaqësues i fshatit Shtupeç i Vogël, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për Ndërtimin e Sistemit të Ujësjellësit në fshatin Shtupeç i Vogël, komuna e Pejës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.12.2025 në ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Pejës, do të organizohet debat publik nga Nezir Iberdemaj përfaqësues i fshatit Shtupeç i Vogël, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/3641684670?pwd=YzRTQjJnSGpzZVlqTmhtUGNnK29mZz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Nezir Iberdemaj përfaqësues i fshatit Shtupeç i Vogël, për Pëlqim Mjedisor, – për Ndërtimin e Sistemit të Ujësjellësit në fshatin Shtupeç i Vogël, komuna e Pejës.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nakëshije Hameli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Vëllezërit Frashëri” Planjë Prizren.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Vlora Duraj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Bajram Curri” në Romaj.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

